

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.R., F.D., M.R., që të tre nga, K. e, për shkak se në bashkëveprim si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parag.1 nënparag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1600/2014, i dt.19.08.2014, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, më dt.15.12.2015 komunikoi, ndërsa më dt.22.12.2016 përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F.R., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë për veprën penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprën tjetër penale.

2. M.R., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë për veprën penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprën tjetër penale.

Në bazë të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të KPPRK-së,

Lirohen nga akuza

Sepse më datë 18.07.2014 rreth orës 23.00 minuta, në të komunës së, në lokalitetin e të pandehurit F.R., për shkak të mosmarrëveshjeve rreth pagesës së borgjit për fitoren në lojën e bilardos, janë marr vesh në mes vete dhe së bashku i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupor të cilat kanë rezultuar me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të dëmtuarit S.K. nga fshati i komunës së, në atë mënyrë që i pari e kap për fyti i pandehuri i parë F.R. dhe e mbështetë për muri , kurse më pas ndërhyjnë edhe F. e M.R. duke e kap për duarsh dhe duke e mbajte derisa me grushta dhe shqelma e godit nëpër pjesë të ndryshme të trupit i pandehuri F. dhe më pas që të tre këta të pandehur e tërheqin zvarrë të dëmtuarin e qesin në rrugë dhe aty vazhdojnë ta shqelmojnë dhe grushtojnë dhe e lënë të shtrirë, me ç'rast të njëjtit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore në formë të ndryshme të indeve të buta dhe enjtje në regjionin e shpinës si dhe gërvishje në bërryla

të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës, që për pasojë kanë dëmtimin e përkohshëm të shëndetit .

- me çka kishin për të kryer në bashkëveprim si bashkekzekutor veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parag.1 nënpara. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari S.K. nga, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil .

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1600/2014 prej datës 19.08.2014, ka akuzuar: F.R., F.R., M.R., që të tre nga, K. e, për shkak se në bashkëveprim si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parag.1 nënparag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pranë të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që gjykata nga provat e shtjelluara dhe pas krahasimit detal të të njëjtave të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe t'i dënojë në përputhje me ligjin.

Gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së ka bërë veçimin e procedurës penale për të akuzuarin F.R., procedura për të njëjtin është zhvilluar dhe është përfunduar ndaras me aktgjykimin numër P.nr.261/2014 të datës 04.05.2015.

I akuzuari F.R. në mbrojtjen e tij nuk konteston faktin se, natën konkrete ka pasur një përleshje në mes F.R. dhe S.K., se si ka filluar përleshja nuk ka njohuri pasi nuk ka qenë mbrenda në lokal, fillimisht i njëjti ka qenë në lokalin në afërsi të lokalit të bilardos dhe pas dëgjimit të zhurmës ka vrapuar tek lokali ku është ndëgjuar zhurma, me të hyrë mbrenda ka parë se F.dhe S. kanë qenë duke u përleshur, së bashku me M.R. kanë ndërhyrë dhe i kanë ndarë, derisa kanë qenë në një largësi prej 3 metrave njëri nga tjetri tani i dëmtuari S.ka marr një shishe të xhamit që e ka pasur afër e ka thyer dhe është munduar ta gjuajë F., mirëpo nuk ka arritur ta gjuajë pasi e kanë penguar, pas qetësimit të situatës personat që ishin në lokalin e bilardos e me ta F., M., S. dhe ai janë dalur nga lokali i bilardos, mirëpo S. është nisur që të hy mbrenda në të njëjtin lokal për ti lënë topat e bilardos të cilët i kishin mbetur në xhep dhe në ato momente e ka goditur nga mbrapa F., e pas kësaj prapë kanë filluar përleshjen në mes vete gjatë përleshjes, janë

rrokullisur 5-6 metra në një teposhtëze, prapë i ka ndarë M.R., as gjithë kësaj të njëjtit kanë shkuar në shtëpitë e tyre pa u ankuar për lëndime, nuk ka pasur njohuri se S. ka pësuar lëndime se po ta kishte ditur vetë do ta kishte dërguar te mjeku.

Në fjalën përfundimtare nuk e ndien veten fajtor për veprën penale të cilën prokuroria ia vë në barrë, kërkon nga gjykata që t'i shqyrtoj sa më drejtë të gjitha provat që disponon dhe ta liroj nga përgjegjësia penale pasi nuk është kryerës i kësaj vepre penale .

I akuzuari M.R. në mbrojtjen e tij nuk konteston faktin se, në vitin 2014, ka qenë duke lozur bilardo në fshatin ku prezentë kanë qenë: F.R., F.D., XH.R., S.K. e persona tjerë dhe pasi kanë përfunduar lojën e bilardos me F.D. e S.K. pas pak ka vërejtur se ka filluar përleshja në mes F. dhe S. menjëherë ka ndërhyrë e ka larguar F. nga S.e ndërkohë në lokalë ka ardhur edhe F.R., pasi i kanë larguar nga njëri tjetri S. ka marr një shishe të birrës e ka thyer dhe ka tentuar ta gjuajë F. mirëpo nuk ka arritur pasi e kanë penguar, pas kësaj është qetësuar situatat janë dalur jashtë lokalit, i njëjti është nisur për në shtëpi dhe ka ndëgjuar S. te ketë thënë se do hy në lokal për ti lëndë dy topa të bilardos dhe për ti marr qelsat që i kanë rënë në lokal, S. duke shkuar nga mbrapa e ka goditur F. dhe në ato momente prapë ka filluar përleshja ku F., S. e ka përplasur për tokë dhe janë rrokullisur në një teposhtëzë diku 5-6 metra, prapë ka ndërhyrë i ka ndarë dhe pas kësaj kanë shkuar nëpër shtëpitë e tyre, i dëmtuari S. për rrethin njihet si person problematik, ngatërrestar dhe si person që shumë herë është ra ndesh me ligjin.

Në fjalën përfundimtare nuk e ndien veten fajtor për veprën penale të cilën prokuroria ia vë në barrë, kërkon nga gjykata që t'i shqyrtoj sa më drejtë të gjitha provat që disponon dhe ta liroj nga përgjegjësia penale pasi nuk është kryerës i kësaj vepre penale .

Në këtë çështje penale gjykata procedoi provat si më poshtë:

Ka dëgjuar dëshmitarët: Xh.R., F.D., E.D., ka lexuar deklaratën e të dëmtuarit S. K. dhënë para zyrtarëve policor, ka bërë leximin e shkresave si: ekspertizën mjeko ligjore në emër të S. K. e datës 13.08.2014, raportin nga spitali Regjional i Gjilanit me nr.10953 i datës 19.07.2014 në emër të S.K. si dhe është shikuar fotodokumentacioni bashkangjitur lëndës.

Dëshmitarët: Xh.R. e F.D. në dëshminë e tyre kanë deklaruar, se ditën konkrete kanë qenë në lokalin e bilardos pronë e F.R., ku preznetë kanë qenë, F.R., S.K., M.R. edhe disa të tjerë, derisa sa kanë qenë duke lozur bilardo F.dhe S. për një moment kanë dashur të përleshur, mirëpo M. ka ndërhyrë dhe i ka ndarë , pas pak në lokal ka ardhur edhe F.R. në ato momente S. ka marr një shishe të xhamit e ka thyer në pragun e lokalit dhe ka dashur ta godas F.R., mirëpo

kanë ndërhyrë F.R. duke ia marr shishen nga dora, pas kësaj janë dalur nga lokali dhe kanë parë se S. është kthyer për ti lënë topat e bilardos apo për ti marr qelsat dhe duke hyrë mbrenda e ka goditur me grusht F.pas kësaj prapë të dy janë përleshur dhe duke u shtyrë janë rënë në një teposhtëze përafërsisht diku prej 4 metra, prapë F. e M.R. kanë ndërhyrë për ti ndarë të njëjtit, në asnjë moment nuk i kanë parë tani të akuzuarit duke e goditur tani të dëmtuarin apo duke i krijuar kushte F. që ta godas S. (kanë hyrë në mes tyre dhe i kanë larguar te dy në drejtime të kundërta), ndërsa tani i dëmtuari S.lëndimet sigurisht i ka marr gjatë përleshjes-rrokullisjes me të akuzuarin F.në atë teposhtëze.

Dëshmitari E.G. në dëshminë e tij ka deklaruar, se ditën konkrete, derisa ka qenë në patrullim ka marr një informatë nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Kamenicë (QMFK) se është lajmëruar një person me lëndime trupore të cilin janë duke e trajtuar, menjëherë pas informatës kanë shkuar në QMFK në Kamenicë dhe kanë parë se personi S.K. është duke u trajtuar nga mjeku për lëndimet të cilat i ka marr, ku më pas i njëjti është deklaruar se lëndimet i ka marr në një lokal të bilardos ku ka qenë i sulmuar nga personat: F., F.e M.R., menjëherë janë dalur në vend të ngjarjes ku i kanë intervistuar personat e dyshimt ku njëri nga të dyshuarit F.R. ka pranuar në tërësi se ka kryer veprën penale, ndërsa tani dy të akuzuarit nuk kanë kontestuar faktin se kanë qenë prezentë kur kanë ndodhur rrahja në mes F. e S. në lokalin e bilardos, mirëpo mohojnë në tërësi që të njëjtit ta kenë rrahur-goditur tani të dëmtuarit S., për policinë tani të akuzuarit F. e M.R. nuk njihen si persona problematik ndërsa i dëmtuari njihet si person problematik. *Hetimet sipas hetuesit janë bazuar në deklaratën e të dëmtuarit dhe në deklaratat të të dyshuarëve dhe nuk kanë parë të arsyeshme të marrin deklaratat apo prova tjera për të vërtetuar gjendjen faktike, edhe pse në rastin konkrete ka pasur edhe persona tjerë –dëshmitarë okular, e që ka pasur dëshmitarë okular i njëjti është bazuar në përvojën e tij pasi ai lokal është i frekuentuar gjithherë me njerzë.*

Dëshmitari i propozuar në aktakuzë I.K. ka qenë i pa kapshëm për gjykatën sipas konfirmimit të policisë, andaj prokurori i shtetit heq dorë nga ndëgjimi i këtij dëshmitari e të njëjtin propozim e ka aprovuar edhe gjykata.

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korrelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarve në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës. Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata ka gjetur se nuk është dëshmuar me prova se të akuzuarit F. e M.R. kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në ngarkesë.

Gjykata analizoi deklaratën e të dëmtuarit, mirëpo kësaj deklarate nuk ia fali besimin në tërësi ngase kjo deklaratë nuk ka mundur të kundërshtohet nga të pandehurit ose mbrojtësit përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale në kuptim të nenin 262 të KPP-së.

Gjykata nga deklaratat e dëshmitarit zyrtarit policor E.G. vërtetoi faktin se i dëmtuari natën konkrete ka pësuar lëndime trupore për të cilat lëndime është trajtuar fillimisht në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kamenicës (QMFK) e më pastaj edhe në spitalin regional të Gjilanit, mirëpo nuk mundi të vërtetoj faktin se tani dy të akuzuarit M. e F.R. ti kenë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit S. K., ndërsa nga dy dëshmitarët okular Xh.R. e F.D. vërtetuan faktin se tani të akuzuarit në asnjë moment nuk e kanë goditur të dëmtuarin.

Në këtë çështje penalo juridike nuk është kontestues fakti se natën konkrete ka ndodhur një përleshje në mes F.R. dhe S.K. gjithashtu nuk është kontestuese dhe nuk kontestohet nga askush e as nga të akuzuarit se në kohën kur ka ndodhur përleshje në bilardo kanë qenë edhe M. e F.R., mirëpo kontestuese dalin të jenë rrethanat se natën konkrete a e kanë goditur të akuzuarit të dëmtuarin dhe nga goditjet e të akuzuarëve F. e M.R. a ka marr lëndime i dëmtuari. Se i dëmtuari natën kritike ka marr lëndime trupore nuk kontestohet dhe vërtetohet nga raporti mjekësor i spitalit regional të Gjilanit me nr.10953 i datës 19.07.2014, nga ekspertiza mjeko ligjore e datës 13.08.2014 dhe nga aktgjykimi P.nr.261/2014 të datës 04.05.2015 ndaj të akuzuarit F.R. i cili është bërë i plotfuqishëm pasi nuk është kundërshtuar nga i akuzuari F.R., mirëpo kontestuese del fakti se lëndimet trupore i dëmtuari ai ka marr nga tani të akuzuarit .

Mbrojtjen e të akuzuarve e mbështesin dëshmitë e dëshmitarëve Xh.R., F.R., gjithashtu edhe dëshmia e hetuesit E.G. , i cili deklaron se të akuzuarit F. e MR. për policinë nuk njihen si person problematik ndërsa i dëmtuari njihet si persona problematik (për këtë arsye gjykata analizoi personalitetin e të dëmtuarit dhe nuk e mori deklaratën e të njëjtit si dëshmi kredibile), andaj gjykata në bazë të një vlerësimi të mirëfilltë erdhi në përfundim se nuk u vërtetua se të akuzuarit kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag.1 nën parag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e sipas dispozitave të KPPRK-ës përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse, pra në rastin konkret nuk është vërtetuar e njëjta, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, prandaj në të drejtën penale vlenë parimi”Indubio Pro Reo”, pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij në mbështetje të nenit 3 parag. 2 të KPPRK-së.

I dëmtuari Selami Krasniqi për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Për shpenzimet e procedurës penale, gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

Për arsye të parashtura më lartë, gjykata konform nenit 364.pika 1. e KPRK-s, vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË

P.nr.133/2015, më datë 22.12.2016

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej
15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.